

VENDIM
Nr. 851, datë 24.12.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN
NR. 387, DATË 25.5.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
‘PËRMIRËSIMI I SHTRESAVE RRUGORE FUSHË-KRUJË–THUMANË’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 387, datë 25.5.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 3, nënndarja “- tokë ‘arë’ dhe ‘truall’ me sipërfaqe 12 648 m², me vlerë 5 409 102 (pesë milionë e katërqind e nëntë mijë e njëqind e dy) lekë zëvendësohet me “- tokë ‘arë’ dhe ‘truall’ me sipërfaqe 11 745 m² me vlerë 5 180 643 (pesë milionë e njëqind e tetëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e tre) lekë.

b) Në pikat 3 dhe 4, vlera “... 16 686 204 (gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e katër) lekë ...” zëvendësohet me “... 16 457 745 (gjashtëmbëdhjetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e dyzet e pesë) lekë ...”.

c) Në tabelën bashkëlidhur vendimit, nënndarjet me numra rendorë 5, 6, 7, 8 dhe 9, ndryshohen dhe në fund të tabelës shtohen nënndarjet me numra rendorë 42, 43 dhe 44, përkatësisht, sipas tabelave “B” dhe “A” që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale, me vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTTI, PËR SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 387, DATË 22.5.2016, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTI ‘PËRMIRËSIMI I SHITRESAVE RRUGORE FUSHË-KRUJË–THUMANË’”.

Tabela A, që pasqyron pasuritë e shtuara

Tabela A

Nr. rendor në VKM	Pronari			Të dhënat (mbi pasurinë sipas ASHK-së)				Shpronësimet tokë “arë”			Vlera totale	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri					Sip. (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)		
42	GJOK	ZEF	MUSTEQJA	2537	68/50	Are	4391	571	253	144463	144,463	Konfirmuar nga ASHK-ja
43	BRIKENA	NUE	SHIJAKU	2537	68/46	Are	2504	169	253	42757	42,757	Konfirmuar nga ASHK-ja
44	AGETINA	NUE	ÇURO (MUSTEQJA)	2537	68/48	Are	2595	69	253	17457	17,457	Konfirmuar nga ASHK-ja
SHUMA								809		204,677	204,677	

Tabela B, që pasqyron ndryshimet e bëra në tabelën bashkëlidhur VKM-së nr. 387, datë 25.5.2016

DATE 25.5.2019

Nr. rendor në VKM	Pronari			Të dhënat (mbi pasurinë sipas ASHK-së)				Sipërfaqet që ndryshojnë				Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri					Shpronësimet tokë “arë”			Vlera totale	
				ZK	Nr. pas.	Lloji i pas.	Sip. totale	Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
5	ELIDA	NUE	SHKRETA (MUSTEQJA)	2537	68/44	Are	2489	317	253	80201	80,201	Konfirmuar nga ASHK-ja
6	GLADIOL A	NUE	MUSTEQJA	2537	68/42	Are	2439	417	253	105501	105,501	Konfirmuar nga ASHK-ja
7	LEONORA	NUE	LLESHI (MUSTEQJA)	2537	68/40	Are	2399	409	253	103477	103,477	Konfirmuar nga ASHK-ja
8	LEONORA	NUE	LLESHI (MUSTEQJA)	2537	68/38	Are	2279	377	253	95381	95,381	Konfirmuar nga ASHK-ja
9	MARIE	ZEF	MUSTEQJA	2537	68/36	Are	2212	25	253	6325	6,325	Konfirmuar nga ASHK-ja
SHUMA								1545	253		390,885	

Shënim.

1. Për tokën “arë”, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.

